



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE  
KRYETARI

URDHËR

Nr. 541 datë 14.04.2014

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT DHE FORMULARIT TIP TË  
NEVOJSHËM PËR APLIKIMIN E SUBJEKTEVE TË PËRFSHIRA NË  
TRANSFERIMET NDËRKOMBËTARE NË RASTET KUR MALLRAT ME KOD  
DOGANOR TË NJËTË MUND TË KONSIDEROHEN SI MALLRA ME PËRDORIM  
TË DYFISHTË**

Mbështetur në Kreun IV, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.43, datë 16.01.2008 "Për organizimin, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve", të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.304, datë 25.03.2009 "Për përcaktimin e procedurave për kryerjen e ekspertizave dhe kontrollit nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve" dhe të pikës 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.305, datë 25.03.2009 "Për përcaktimin e procedurës së lëshimit të dokumentave ligjorë të garancisë, në fushën e kontrollit shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarakë dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë":

**URDHËROJ:**

1. Subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave, të cilat mund të konsiderohen si mallra me përdorim të dyfishtë, të paraqesin pranë AKSHE-së dokumentacionin si më poshtë:
  - a. Kërkesë për pajisjen me vërtetim
  - b. Formulari tip i plotësuar në mënyrë elektronike
  - c. Fatura invoice
  - d. Specifikimet teknike të mallit
  - e. Dokumentacionin e eksportit që shoqëron mallin
  - f. Deklaratë e subjektit aplikues mbi vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur.

2. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, pas plotësimit të dokumentacionit, të lëshojë vërtetimin mbi përjashtimin e mallrave nga listat e mallrave me përdorim të dyfishtë, nëse malli nuk përfshihet në listën e mallrave.
3. Urdhëri i Kryetarit të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve Nr. 14, datë 06.01.2011, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fyqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

**KRYETARI**

**Engjëllush BEKTESHI**

